

VENDIM
Nr. 547, datë 18.6.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË
“BERAT-KONFEKS”, SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “ISH-REPARTI I
NGJYROSJES NË ISH-KOMBINATIN E TEKSTILEVE BERAT” (PJESA E MBETUR),
NË “BERATEKS”, SHA, BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiletozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Berat-Konfeks”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-reparti i ngjyrosjes në ish-Kombinatit e Tekstileve Berat”, (pjesa e mbetur), në “Berateks”, sh.a., Berat, me sipërfaqe të përgjithshme 5 497 (pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², nga e cila, sipërfaqe ndërtimore, sipas genplanit, përkatësisht, kati i parë, 2153 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) m², kati përdhe 2148 (dymijë e njëqind e dyzet e tetë) m², si dhe sipërfaqe funksionale 1196 (një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI ISH REPARTI I NGJYROSJES NE PRONESI TE SHOQERISE BERATEKS SH.A. BERAT
SHK. 1: 1000 (SIP. TOTALE TAKUESE PJESA "B")



POSICIONI KADASTRALE

- ZONA KADASTRALE 8001
- NR. PLO. 19.00 VOL. 02
- NIVELI I NIVELIT: 06-D-4
- SHALLA 1: 2000
- ADRESA E PAKUJES / BERTAT
SHI KOMBRIATI I TRISTAVES 0001
- PRONESI: SHIFRAT: SH.A. BERAT

ADRESA E TITULLIT

YFILLIMET E TIRANES
UNDO: SH. PLO. 19.00
JUGU: SH. PLO. 19.00
PREDIKIM: SH. PLO. 19.00



legjendet:

Shifrat e propozimit te pjeses me qene

- Aportaja e peng/lluhura (sh.plo.pun+sh.plo.tedhloca) eble 1497m²
- Aportaja e (19/03/0*) hoteli pun eble 1102m²
- Aportaja e (19/03/0*) hoteli eble 1148m²
- Aportaja e hotelloca (19/03/0*) e jullite eble 1196m²



- eble 1497m²
- eble 1102m²
- eble 1148m²
- eble 1196m²

PER SHOQERISE BERATEKS SH.A.

